

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Luan Berisha, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Naxhis Sharani procesmbajtëse, në lenden penale kundër të akuzuarve D. A. dhe M. S. , të dy nga fshati Zh. , Komuna e Prizrenit, për shkak të dy veprave penale vjedhje e rëndë në bashkë kryerje nga neni 327 par.1 nën par.1.1 e lidhur me nenin 31 të KP-së, sipas aktakuzave të Prokurorisë Themelore në Prizren PP.nr.3061/2015 të datës 26.10.2015 dhe PP.nr.3051/2015 të datës 26.10.2015, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në prezencën e Prokurorit të shtetit në Prizren Beqë Shala, të akuzuarve dhe mbrojtësve të akuzuarve avokat B. S. dhe F. Sh. , me datë 09.11.2015 morri dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

1.D. A. , nga i ati H. dhe nëna Gj. e lindur N. , i lindur me datë ..., në fshatin Zh. , Komuna e Prizrenit, ku edhe tani jeton, ka të kryer shkollën fillore, me profesion mekanik, i pa martuar, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

2.M. S. , nga i ati M. dhe nëna Gj. e lindur G., i lindur më ..., në Prizren, tani jeton në fshatin Zh., Komuna e Prizrenit, ka të kryer shkollën fillore, me profesion fasader, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

JANË FAJTOR

I.Se me datën 11.10.2015, në kohë të pa përcaktuar, në fshatin Zh., saktësisht në oborrin e Qendrës së Mjekësisë familjare të fshatit, në bashkë veprim ia marrin pasurinë e luajtshme të tjetrit me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete, në atë mënyrë që të pandehurit D. A. dhe M. S. , në bashkë veprim kanë vjedhur rreth 60 litra naftë, pasi që i shpojnë rezervarin e auto ambulancës i markës “Ford Kombi”, me targa të regjistrimit .. - ... -AP, ngjyrë e bardhë, i cili ishte i parkuar në oborrin e Q.K.M. të fshatit Zh., dhe nga aty marrin një sasi rreth 60 litra të derivateve të naftës,

Këso dore kanë kryer vepër penale vjedhje e rëndë nga neni 327 par.1 nën par.1.1 e lidhur me nenin 31 të KP-ës.

II.Se me datën 11.10.2015, rreth orës 11,50 minuta, në fshatin Zh., saktësisht në kazinon “Cayot”, pronë e të dëmtuarit K. E. , në bashkë veprim ia marrin pasurinë e luajtshme të tjetrit me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete, në atë mënyrë të pandehurit pasi në kokat e tyre vendosin batanije, në bashkë veprim duke thyer me forcë derën e lokalit hynë brenda në lokal ku nga aty marrin 200 Euro të holla dhe një video kamerë, me qëllim të përvetësimit për

vete, dalin nga lokali pa u diktuar pasi që të njëjtit janë incizuar nga kamerat e sigurisë, të pandehurit janë zënë nga ana e zyrtarëve policor,

Këso dore kanë kryer veprë penale vjedhje e rëndë nga neni 327 par.1 nën par.1.1 e lidhur me nenin 31 të KP-ës.

Andaj gjykata në kuptim të nenit 7,41,43 par.1 pika 1.2 dhe.1.3, 45, 46, 73, 74, 75, 76 dhe nenit 327 par.1 nën par.1.1 e lidhur me nenin 31 të KP-ës, të akuzuarve ju shqipton:

Të akuzuarit të pare D. A. :

Për veprën penale nën I. të dispozitivit, nga neni 327 par.1 nën par.1.1 e lidhur me nenin 31 të KP-ës

Denim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti e 2 (dy) muaj burg, si dhe dënim me gjobë në shumë prej 250 (dyqindpesëdhjetë) euro,

Për veprën penale nën II. të dispozitivit nga neni 327 par.1 nën par.1.1 e lidhur me nenin 31 të KP-ës

Denim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti e 2 (dy) muaj burg, si dhe dënim me gjobë në shumë prej 250 (dyqindpesëdhjetë) euro,

Konform nenit 80 par.1 dhe 2 pika 2.3 dhe 2.4 të KPP-ës, gjykata të akuzuarit i shqipton dënimin unik, dhe ate

Denim me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) viteve e 3 (tre) muaj burg, si dhe dënim me gjobë në shumë prej 500 (pesëqind) euro,

Të akuzuarit të dytë M. S. :

Për veprën penale nën I. të dispozitivit, nga neni 327 par.1 nën par.1.1 e lidhur me nenin 31 të KP-ës

Denim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti e 2 (dy) muaj burg, si dhe dënim me gjobë në shumë prej 250 (dyqindpesëdhjetë) euro,

Për veprën penale nën II. të dispozitivit nga neni 327 par.1 nën par.1.1 e lidhur me nenin 31 të KP-ës

Denim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti e 2 (dy) muaj burg, si dhe dënim me gjobë në shumë prej 250 (dyqindpesëdhjetë) euro,

Konform nenit 80 par.1 dhe 2 pika 2.3 dhe 2.4 të KPP-ës, gjykata të akuzuarit i shqipton dënimin unik, dhe ate

Denim me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) viteve e 3 (tre) muaj burg, si dhe denim me gjobë në shumë prej 500 (pesëqind) euro,

Obligohen të akuzuarit të paguajnë shpenzimet në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 20 euro, secili veç e veç të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmrisë të këtij aktgjykimi, nën kërcnim të ekzekutimit të dhunshëm.

Të dëmtuarit Qendra e mjekësisë familjare në Prizren dhe K. (R.) E., nga fshati Zh., Komuna e Prizrenit, për realizimin e kërkesës pronësoro juridike udhëzohen në kontest të rregullt civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, kësaj gjykate i ka parashtruar aktakuzat PP.nr.3061/2015 të datës 26.10.2015 dhe PP.nr.3051/2015 të datës 26.10.2015, kundër të akuzuarve D. A. dhe M. S. , të dy nga fshati Zh. , Komuna e Prizrenit, për shkak të dy veprave penale vjedhje e rëndë në bashkë kryerje nga neni 327 par.1 nën par.1.1 e lidhur me nenin 31 të KP-së.

Në shqyrtimin fillestar me datë 09.11.2015, mbrojtësit e të akuzuarve avokat B.S. dhe avokat F. Sh. , kanë propozuar gjykatës që duke pasur parasysh rrethana dhe kohën e kryerjes të dy veprave penale, dhe se në këtë gjykatë janë dy lëndë penale të cilat evidentohen në emër të mbrojturve të tyre, dhe ate P.nr.1799/2015 dhe P.nr.1780/2015, që ndaj të njëjtëve të zhvillohet procedurë unike, duke pasur parasysh që veprat penale të kryer nga ana e të mbrojturve të tyre janë të njëjtës natyrë, si dhe me qëllim të ekonomizimit të procedurës.

Gjykata konform dispozitave ligjore dhe ate nenit 35 par.7 dhe 8 të KPP-ës, në shqyrtimin me datë 09.11.2015, ka aprovuar propozimin e mbrojtësve të akuzuarve, të cilin propozim prokurori i shtetit i ka lënë në vlerësim gjykatës, dhe ka vendosur që ndaj të akuzuarve të cekur të zbatohet procedurë unike me rastin e bashkimit të lëndëve P.nr.1779/2015 sipas aktakuzës të Prokurorisë themelore në Prizren PP.nr.3061/2015 të datës 26.10.2015, dhe P.nr.1780/2015, sipas aktakuzës të Prokurorisë themelore në Prizren PP.nr.3051/2015 të datës 26.10.2015, për shkak të dy veprave penale vjedhje e rëndë në bashkë kryerje nga neni 327 par.1 nën par.1.1 e lidhur me nenin 31 të KP-së, dhe këto dy lëndë do të evidentohen nën numrin P.nr.1779/2015.

Prokurori i shtetit Beqë Shala, në fjalën e tij përfundimtare deklaron: qëndroj në tërësi pranë aktakuzave PP.nr.3051/2015 të datës 26.10.2015, dhe PP.nr.3061/2015 të datës 26.10.2015, kundër të akuzuarve D. A. dhe M. S. , të dy nga fshati Zh. , Komuna e Prizrenit, për shkak të dy veprave penale vjedhje e rëndë në bashkë kryerje nga neni 327 par.1 nën par.1.1 e lidhur me nenin 31 të KP-së, dhe i propozoj gjykatës që të akuzuarit ti shpall fajtor dhe ti dënoj sipas ligjit, duke u bazuar në dispozitat e KP, meqenëse këtu të akuzuarit në shqyrtimin fillestar në mënyrë vullnetare e pranuan fajësinë për të dy veprat penale si në aktakuzat e cekura, i propozoj gjykatës që ti merr parasysh të gjitha rrethana cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, e si rrethanë lehtësuese të merr parasysh pranimet e fajësisë nga e të akuzuarve në mënyrë vullnetare për veprat penale të cilat ju vihen në barë.

Mbrojtësi i të akuzuarit D. A., avokat B. S. , në fjalën e tij përfundimtare deklaron: unë si mbrojtës i të akuzuarit D. A. , lidhur me gjendjen faktike të mbrojturit tim për të dy veprat penale nuk kam çka të shtoj, ngase i njëjti në mënyrë vullnetare ka pranuar fajësisë për të dy veprat penale që i vihen në barë me aktakuzat e prokurorisë themelore në Prizren. nga kjo i kisha propozuar gjykatës që duke pasur parasysh të cekuat më lart, moshën e të mbrojturi tim, rrethanat nën të cilat është kryer, është hera e parë që bie në konflikt me ligjin, premtimin e të njëjtit që në të ardhmen do të jetë më i kujdesshëm dhe do të përmbahet nga veprimet e tilla, pendimin i tij thellë për veprën e kryer, është punëtor, dhe se i njëjti edhe sot para gjykatës ka shprehur bashkë punimin e plotë me organet kompetente që nga faza e fillimit të kësaj procedure e deri më tani, konsideroj që të gjitha këto rrethana janë rrethana mjaftueshme të cilat gjykata duhet ti ketë parasysh si rrethana lehtësuese me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin.

Po ashtu i propozoj gjykatës që ndaj të mbrojturit tim me ditën e sotme të ndërpritet paraburgimi, meqenëse kanë pushuar edhe kushtet ligjore për të cilat edhe është caktuar i njëjti.

I akuzuari i parë D. A. , në fjalën e tij përfundimtare deklaron: e përkrahi dhe mbështet fjalën përfundimtare të mbrojtësit tim, dhe po ashtu edhe një herë e shpreh pendimin e thellë për veprat e kryera penale të cilat më vihen në barë.

Mbrojtësi i të akuzuarit M. S. , avokat F. Sh. , në fjalën e tij përfundimtare deklaron: duke pasur parasysh faktin e pranimit të fajësisë nga ana e të mbrojturit tim, mua nuk më mbetet asgjë tjetër pos të propozoj gjykatës që të gjitha rrethanat lehtësuese konform nenit 73 të KP-ës, pasi që i mbrojturi im që nga fillimi ka bashkë punuar me organet kompetente, pendimin e thellë të tij, është i moshës së re, premtimin e tij që në të ardhmen nuk do të përsërisë veprat të tilla apo të ngjashme, konsideroj që janë rrethanat e mjaftueshme të cilat gjykata duhet ti ketë parasysh si rrethana lehtësuese me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin.

Po ashtu i propozoj gjykatës që ndaj të mbrojturit tim me ditën e sotme të ndërpritet paraburgimi, meqenëse kanë pushuar edhe kushtet ligjore për të cilat edhe është caktuar i njëjti.

I akuzuari i dytë M. S. , në fjalën e tij përfundimtare deklaron: në tërësi e përkrahi dhe mbështet fjalën përfundimtare mbrojtësit tim avokat F. Sh. , dhe po ashtu edhe një herë para gjykatës shprehi pendimin e thellë për veprat penale të kryera të cilat më vihet në barë.

Gjykata në shqyrtimin kryesor ka vërtetuar këtë gjendje faktike.

I.Se me datën 11.10.2015, në kohë të pa përcaktuar, në fshatin Zh., të akuzuarit, saktësisht në oborrin e Qendrës së Mjekësisë familjare të fshatit, në bashkë veprim ia marrin pasurinë e luajtshme të tjetrit me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete, në atë mënyrë që të pandehurit D. A. dhe M. S. , në bashkë veprim kanë vjedhur rreth 60 litra naftë, pasi që i shpojnë rezervarin e auto ambulancës i markës “Ford Kombi”, me targa të regjistrimit .. - ... - AP, ngjyrë e bardhë, i cili ishte i parkuar në oborrin e Q.K.M. të fshatit Zh. , dhe nga aty marrin një sasi rreth 60 litra të derivateve të naftës,

II.Se me datën 11.10.2015, rreth orës 11,50 minuta, në fshatin Zh., të akuzuarit, saktësisht në kazinon “Cayot”, pronë e të dëmtuarit K. E. , në bashkë veprim ia marrin pasurinë e luajtshme

të tjetrit me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete, në atë mënyrë të pandehurit pasi në kokat e tyre vendosin batanije, në bashkë veprim duke thyer me forcë derën e lokalit hynë brenda në lokal ku nga aty marrin 200 Euro të holla dhe një video kamerë, me qëllim të përvetësimit për vete, dalin nga lokali pa u diktuar pasi që të njëjtit janë incizuar nga kamerat e sigurisë, të pandehurit janë zënë nga ana e zyrtarëve policor,

Gjykata gjendjen e këtyre faktike e ka vërtetuar nga pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarve dhe atë të dy të akuzuarit në shqyrtimin fillestar vullnetarisht kanë pranuar fajin, për shkak së cilës gjykata fare nuk ka administruar provat e propozuara. Sipas detyrës zyrtare gjykata nuk gjeti se ekziston ndonjë provë e pa pranueshme, gjithashtu gjykata në tërësi ka vërtetuar se të akuzuarit kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit për veprat penale të cilat ju vihen në barrë dhe që pranimi i fajit është bërë në mënyrë vullnetare dhe pa kushtëzim dhe mbështetet në fakte dhe prova materiale të cilat janë paraqitur në aktakuzë , për të cilat të akuzuarit kanë qenë të njoftuar me të gjitha provat materiale. Gjykata ka ardhur në përfundim, se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarve është bërë në pajtim me neni 248 të KPPK-ës dhe faktet që përmban aktakuzën në veprimet e të akuzuarve formohen të gjitha elementet e veprave penale dhe atë për shkak të dy veprave penale vjedhje e rëndë në bashkë kryerje nga neni 327 par.1 nën par.1.1 e lidhur me nenin 31 të KP-së, paraprakisht duke vërtetuar përgjegjësinë e tyre penalo juridike për veprat penale që ju vihen në barrë.

Me rastin e marrjes së dënimit ndaj të akuzuarve gjykata vlerësoj të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese në kuptim të dispozitave të nenit 73 të KPK të cilët ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, si rrethana rënduese është marr fakti që të akuzuarit kanë kryer dy vepra penale dhe atë në të njëjtën ditë, në fshatin Zh. , Komuna e Prizrenit, dhe atë në qendrën familjare të fshatit në kohë të pa caktuar dhe në kazinonë “Cayot”, që sipas gjykatës kemi të bëjmë me persona përsëritës të veprave penale, gjegjësisht recidivistat, dhe sipas mendimit të gjykatës të njëjtit kanë prirje për kryerjen e veprave penale të kësaj natyre. Ndërsa rrethanë lehtësuese janë marrë faktet se të akuzuarit kanë bashkëpunuar me organet gjyqësore që nga faza fillestare, të njëjtit kanë pranuar fajësinë për të gjitha veprat penale, janë të moshës së re, pendimet e tyre për veprat penale që i kanë kryer, konform nenit 74 gjykata ka marr parasysht rrethanat personale dhe karakterin e personave të dënuar, moshën e të njëjtëve, bashkë punimin e përgjithshëm të personave të dënuar me gjykatën, bashkë punimi i personave të dënuar në hetimin në ndjekjen penale, pranimin e fajësisë, keq ardhjen e shfaqur nga personat e dënuar, sjelljen e personave të dënuar pas kryerjes së veprës penale, andaj gjykata të akuzuarit i shpalli fajtor dhe ju shqiptoj dënimet dhe atë të akuzuarit të parë D. A. për dy veprat penale dënim unik me burg në kohëzgjatje prej 2 (dy) viteve e 3 (tre) muaj burg, si dhe dënim me gjobë në shumë prej 500 (pesëqind) euro, të cilën shumë i akuzuari është obliguar të paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, e në rast se i njëjti nuk mund të paguaj këtë shumë, dhe se dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet, i njëjti do të zëvendësohet me dënim me burgim, duke llogaritur nga 1 (një) ditë burg për çdo 20 Euro, respektivisht 25 ditë burg, paraprakisht duke i shqiptuar dënimet për secilën vepër penale veç e veç, si dhe të akuzuarit të dytë M. S. , për dy veprat penale dënim unik me burg në kohëzgjatje prej 2 (dy) viteve e 3 (tre) muaj burg, si dhe dënim me gjobë në shumë prej 500 (pesëqind) euro, paraprakisht duke i shqiptuar dënimet për secilën vepër penale veç e veç, të cilën shumë i akuzuari është obliguar të paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, e në rast se i njëjti nuk mund të paguaj këtë shumë, dhe se dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet, i njëjti do të

zëvendësohet me dënim me burgim, duke llogaritur nga 1 (një) ditë burg për çdo 20 Euro, respektivisht 25 ditë burg, duke vërtetuar përgjegjësin e tyre penalo juridike, si dhe duke menduar se dënimi i shqiptuar ju përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së tyre, peshës dhe pasojave të veprave penale të shkaktuara, duke menduar se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen do të jenë më të kujdesshëm dhe do të përmbahen nga veprimet e tilla.

Vendimin mbi shpenzimet e paushallit gjyqësor gjykata e bazoi në kuptim të nenit 450 dhe 451 të KPPK-ës.

Vendimin mbi kërkesën pronësoro juridike gjykata e bazoi në kuptim të nenit 463 të KPPK-ës.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
P.nr.1780/2015 të datës 09.11.2015

Procesmbajtësja
Naxhis Sharani

Gjyqtari
Luan Berisha

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtës, Gjykatës së apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.